




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 25 (njëzet e pesë) vite të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 63/23 i datës 28.04.2023.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. Erhan Morina, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.2. Besmire Bytyqi, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.3. Armir Vuçitërna, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës – PDK;
 - 2.4. Feriz Thaqi, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës – AAK;
 - 2.5. Adelina Paqarizi, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurrimit të hapur, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 25 (njëzet e pesë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për shprehjen e interesit, i cili përfshinë: emrin, përshkrimin, sipërfaqen, destinimin, dhe lokacionin e pronës që jepet në shfrytëzim; afatin e dhënies në shfrytëzim të pronës; veprimtarinë që mund të ushtrohet; afatin e fundit për aplikim; vendin ku bëhet pranimi i ofertave për shprehje të interesit; si dhe informacionet shtesë.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e konkurrimit të hapur dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.69/23
Datë:28.04.2023

